



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Klos, më . . . 2023

PROJEKT VENDIM
Nr. ___ Datë ___ / ___ /2023
PËR DHËNIE MENDIMI PËR FILLIM PROCEDURASH PER DHËNIE NË PËRDORIM
NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUAR NGA SUBJEKTE PRIVATE.

Mbështetur ne "Ligjin 139/2015" për vetqeverisjen vendore "Neni 54" shkonja "e" dhe "k", në zbatim të ligjit nr. 57/2020, "Për Pyjet" në "V.K.M Nr.591 dt.9.10.2018 për disa ndryshime në vendimin Nr.1353 Datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rregulloreve për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të Fondit Pyjorë, Të ndryshuar në pikën "2:", shkonja "Ç" për miratimin me shkrim, për vazhdimin e procedurave, të dhënies në përdorim, me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit Administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave të dhënies në përdorim, i kërkojmë këshillit të bashkisë të.

V E N D O S Ë:

1. Fillimin e procedurave, për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor i kërkuar nga subjekti privat.
 - Subjekti "VANI COMPANY" Sh.p.k me NIUS. L28307901U. Sipërfaqja e kërkuar është në ngastrën nr. 32c, Ekonomia Pyjore Balgjaj 2,
 - Zona Kadastrale 3460.
 - Kodi Kadastral DI 1302 032c
 - Përdorimi i sipërfaqes: Ndërtim të fabrikës për pasurimin e mineralit krom.

KRYETARI I BASHKISË
Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE BUJQËSISË DHE PYJEVE
SEKTORI I I ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Klos, më 20. 10.2023

RELACION SHPJEGUES

PËR DHËNIEN E MENDIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIE NË PËRDORIM, TË SIPËRFAQES SË KËRKUAR, NGA SHOQËRIA "VANI COMPANY" Shpk, " PËR NDËRTIMIN E IMPJANTIT TË PASURIMIT TË MINERALIT KROM", NGA FONDI PYJOR KULLOSOR PËR NJË SIPËRFAQE PREJ 1.235 ha.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Klos

Të nderuar Këshilltarë,

Ky relacion është hartuar duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në mbështetje të ligjit 57/ 2020 “ Për Pyjet”, VKM. NR.559 datë 29/07/2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht, në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, Udhëzimi ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik, si dhe bazuar në kërkesën e ardhur nga subjekti me nr. 20 prot., datë 10.09.2023, protokolluar në Bashkinë Klos me nr.2763 prot., më datë 10.10.2023 “Për hartimin e raportit tekniko- ekonomik”, “Për ndërtim Impjanti për pasurimin e kromit”, në territorin e bashkisë Klos, urdhërin me nr. 129 datë 16.010.2023 të Kryetarit të Bashkisë Klos, për vlerësimin tekniko- ekonomik të sipërfaqeve pyjore/kullosore”, që propozohen të jepen në përdorim për "për ndërtimin e impjantit të pasurimit të mineralit të kromit". Pas verifikimeve të bëra në terren gjurma e Impjantit shtrihet në Ekonominë Pyjore "Balgjaj 2", ngastrat nr. 32c. Grupi i punës i përbërë nga: Ing.Kapllan Allamani P/Sektorit, Alban Hajri Specialist Pyjesh dhe Arbër kuleni specialist pyjesh , nga data 16.10.2023 deri me datë 20.10.2023 studjoi kërkesën e shoqërisë "Vani Company" sh.p.k. dhe realizoi verifikimin në terren dhe regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore e kullosore me objekt: “Ndërtimin e Impjantit të Pasurimit të Mineralit Krom”.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 0.1235 ha në: ngastrën nr. 32c, rruga që do përdorë shoqëria për Imjantin e pasurimit të kromit është rruga Cerujë – Qaf _ Ujk, rrugë e cila përdoret nga subjekti në fjalë ,pasi subjekti në fjalë është i paisur me leje minerare nga Ministria e Mjedisit për shfrytëzim minerali krom me leje minerare 1185/1, me NIUS/NIPT L283079011. Sipërfaqja që do jepet me qera bazohet në VKM. NR.559 datë 29/07/2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", Shtojca nr.1, pika 6, "Për kryerjen e opercioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh ndihmëse në sipërfaqe , Tokë Inproduktive . djerr 1.235 ha x 49500 = 60515 lekë. Tarifë që do paguhet cdo vit.

Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime) ndër vite është 0 lekë.

Vlera e faunës është 0 lekë.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe të akteve të tjera normative sa më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Klos dhe likuidimin e tarifës **prej 60515 (gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë/në vit.**

Tarifë që do paguhet çdo vit.

Tarifat e dhënjes në përdorim/heqjes nga fondi pyjor e kullosor bazohet në VKM. NR.559 datë 29/07/2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", Shtojca nr.1, pika 6, bazohen në afatet kohore sipas grafikut të punimeve të miratuara nga Institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

P/Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Kapllan Allamani





LISTA E KOORDINATAVE

NR	Y	X
A	4430795.907	4604671.767
B	4430892.569	4604698.089
C	4430887.798	4604720.699
D	4430903.864	4604747.531
E	4430881.375	4604784.801
F	4430746.037	4604760.151
G	4430706.096	4604732.994
H	4430733.376	4604710.148
I	4430764.896	4604717.763
J	4430787.711	4604708.201
K	4430817.233	4604703.043

SH 1: 10000

SIPERFAQE TOTALE :

0.012351 km²

VENDODHJA	ZVASHK:ASHK-MAT	INDEKS HARTE:
BASHKIA: KLOS		K-34-89-(A-d)
TE DHENAT E PASURISE	SIP.PASURISE= 12351 m ²	
LLOJI PASURISE:		